



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Dr. sc. Ujkan Bajra

Kryetar i Këshillit Drejtues të UP-së

Nr. Prot.: 9/31

Datë: 22/11/2019

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur më datë 21.11.2019, mori:

V E N D I M

- I. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për vitin akademik 2019/2020 do të ndajë bursa për të gjithë studentët e nivelit bachelor, të cilët i plotësojnë kriteret e propozuara sipas konkursit publik.
- II. Lartësia e bursës universitare për vitin akademik 2019/20, për çdo përfitues do të jetë **650 euro**, e cila ndahet për rezultatet e arritura gjatë viti akademik 2018/19. Bursa ndahet për periudhën e studimeve, përkatësisht për 10 muaj të vitit akademik.
- III. Për studentët që janë përfitues të bursës universitare, ndarja e mjeteve do të bëhet në vitin akademik 2019/20 nga buxheti i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".
- IV. Shërbimi financiar i njësive akademike në bashkëpunim me Shërbimi Financiar të Universitetit të Prishtinës, obligohen që të zbatojë këtë vendim.
- V. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Njësive akademike të UP-së,
3. Këshillit Drejtues të UP-së,
4. Shërbimit financiar të UP-së,
5. Zyrës Ligjore të UP-së,
6. Asistentes së KD-së.



Këshilli Drejtues i UP-së

Dr. sc. Ujkan Bajra – Kryesues i KD-së